

10 vjet

Instituti Pedagogjik i Kosovës

2007 – 2017

Një dekadë kushtuar arsimit



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
2007 – 2017

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Labëri Luzha

Përmbledhi dhe përpunoi:

Fikret Pajaziti

Përktheu:

Osman Osmani

Dizajni:

Fikret Pajaziti

Printoi:

Shtypshkronja – Printing House “Blendi”

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
2007 – 2017

2017

Fjala e drejtorit

Kam kënaqësinë që, në emër të Institutit Pedagogjik të Kosovës, të paraqes këtë Informator, i cili, përmbledhë dhe paraqet punën dhjetëvjeçare të Institutit, që nga viti 2007, deri këtë vit, në vitin 2017.

Instituti Pedagogjik, mbështetur në veprimtarinë e tij, të cilën e realizon përmes punës sistematike krijuese, me qëllim të kërkimit dhe të zhvillimit të njohurive të reja në fushën e edukimit, përmes këtij informatori prezanton punën dhjetëvjeçare të tij. Ky Informator sjellë para opinionit rrugëtimin historik të Institutit, qysh nga themelimi i tij. Gjithashtu, paraqet strukturën organizuese dhe përbërjen e Institutit, duke vazhduar me veprimtarinë kryesore, duke prezantuar të gjitha numrat e revistës sonë "Kërkime Pedagogjike", si dhe të gjitha botimet e hulumtuesve të Institutit, ndër vite.

Instituti ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për implementimin e reformave arsimore në Kosovë. IPK, po ashtu, ka bashkëpunuar edhe me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare. Përmes këtij materiali mund të informoheni më hollësisht për këtë bashkëpunim. Gjithashtu, këtu gjeni edhe hartimin e dokumenteve të ndryshme, si pjesë e fushëveprimtarisë së IPK-së, të cilat shërbejnë si udhëzues praktikë për zbatimin e politikave të reja arsimore në Republikën e Kosovës.

IPK vazhdimisht është munduar ta pasqyrojë gjendjen reale dhe t'u jep rekomandime politikbërësve dhe komunitetit, në përgjithësi, për përmirësimin e politikave dhe për zbatimin praktik të tyre në sistemin edukativ - arsimor. Pra, shfletimi i këtij materiali është një pasqyrim përmbledhës i punës së përkushtuar të hulumtuesve të Institutit, i cili e ndihmon lexuesin ta njeh më afër Institutin Pedagogjik të Kosovës dhe veprimtarinë e tij.



Labëri Luzha

Përmbajtja

| | | |
|-----------|---|-----------|
| I | Historiku | 8 |
| | Objektivat kryesore të themelimit të Institutit | 9 |
| | Synimi i Institutit | 11 |
| | Objektivat e punës së Institutit | 11 |
| | Veprimtaria e Institutit | 12 |
| | Struktura organizative e Institutit | 15 |
| | Sfidat e Institutit | 19 |
| | Infrastruktura ligjore e Institutit | 19 |
| II | Kush jemi ne | 22 |
| | Veprimtaria kërkimore – shkencore | 23 |
| | Veprimtaria themelore | 23 |
| | Veprimtaria specifike | 24 |
| | Parimet e punës | 25 |
| | Aktivitetet e tjera | 26 |

III Organizimi dhe përbërja e Institutit 28

Departamenti i kërkimeve në edukim 29

Departamenti i shërbimeve të përgjithshme 30

Organogrami 31

Këshilli Drejtues, Këshilli Shkencor, Drejtori si dhe Sekretari shkencor i Institutit 32

Stafi aktual i Institutit 35

IV Botimet 38

V Bashkëpunimet 60

VI Trajnimet 66



I.

Historiku

Objektivat kryesore të themelimit të Institutit
Pedagogjik

Synimi i Institutit

Objektivat e punës së Institutit

Veprimtaria e Institutit

Struktura organizative e Institutit

Sfidat e Institutit

Infrastruktura ligjore e Institutit

Nisma për themelimin e Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK) ka filluar në mars të vitit 2003 në Milano të Italisë, kur janë takuar grupet punuese për hartimin e projektit të bazuar në marrëveshjen paraprake mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Centro Europa Scuola Educazione Societa (CESES).

Qëllimi i marrëveshjes ishte që të siguronte kornizën e një projekti për themelimin e Institutit Pedagogjik të Kosovës, i cili do të centralizonte nismat që lidhen me hulumtimet dhe trajnimet në sektorë të ndryshëm të arsimit në Kosovë. Instituti mendohej të ishte një entitet publik, që operon si trup i pavarur, por nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i specializuar në fushën e edukimit dhe zhvillimit profesional të stafit mësimdhënës në Kosovë.

Sipas kësaj marrëveshjeje të themelimit, Instituti Pedagogjik i Kosovës do të jetë i përkushtuar për zhvillimin e arsimit, i shtrirë në tërë vendin, si dhe të unifikojë nismat e veçanta të një entiteti lidhur me hulumtimin, inovacionin dhe trajnimin në sektorin e arsimit.

Objektivat kryesore të themelimit të Institutit Pedagogjik:

1. Themelimi i një institucioni publik, i cili do të unifikonte dhe koordinonte të gjithë sektorët e arsimit në Kosovë,
2. Trajnimin e personelit, me qëllim të modernizmit dhe vendosjes së standardeve evropiane në sistemin e shkollave në Kosovë, dhe
3. Përkrahjen e zhvillimit të sistemit mësimor me anë të trajnimit të mësimdhënësve dhe të stafit administrativ, të hulumtimeve dhe eksperimenteve pedagogjike dhe didaktike, duke iu adresuar

mësimdhënësve, drejtorëve dhe stafit administrativ, që punojnë në sistemin arsimor.

Grupet dypalëshe e kanë përfunduar punën e draftit të parë në prill të vitit 2004 dhe i është dorëzuar institucioneve vendimmarrëse në tetor të vitit 2005. Si i tillë, projekti miratohet nga MASHT-i, nga Qeveria italiane (Ministria e Punëve të Jashtme) dhe nga C.E.S.E.S.

Në mars të vitit 2006 në Prishtinë prezantohet projekti i Institutit Pedagogjik të Kosovës. Poashtu, në muajin mars 2006 emërohet Këshilli Drejtues dhe Këshilli Shkencor nga MASHT-i. Kështu, më 30 qershor deri më 10 korrik 2006, për Këshillin Drejtues dhe Këshillin Shkencor të Institutit është organizuar një vizitë studimore në Milano të Italisë.

Në dhjetor 2006 është siguruar hapësira e punës, përkatësisht selia e përkohshme e IPK-së dhe ka filluar vendosja e inventarit dhe infrastrukturës së përkohshme për punë.

Në shkurt të vitit 2007 është publikuar konkursi publik për sigurimin e personelit hulumtues të IPK-së, në të cilin paraqiten mbi 200 aplikacione.

Në mars 2007, mbi bazën e konkursit, komisioni intervistues ka bërë përzgjedhjen sipas sektorëve dhe zyrave të parapara me strukturimin e IPK-së.

Prej 16 deri më 30 qershor 2007 janë organizuar kurse intensive profesionale për personelin hulumtues të Institutit Pedagogjik, të cilat janë mbajtur nga ekspertë të institucioneve arsimore të Milanos. Ndërsa, në periudhën kohore korrik – gusht 2007 janë bërë përgatitjet e fundit për fillimin e punës së IPK-së, me ç'rast është vendosur inventari dhe pajisjet tjera të punës, të siguruara nga pala italiane.

Pas gjithë këtij rrugëtimi, më 3 shtator 2007 Instituti Pedagogjik i Kosovës filloi punën si institucion publik kërkimor – shkencor, që merret me hulumtime, trajnime, vlerësime dhe inovacione në fushën e arsimit.

Synimi i Institutit


Instituti Pedagogjik i Kosovës, pasi filloi punën, synoi të jetë në funksion të përmirësimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të cilësisë në arsimin e Kosovës, duke e ngritur atë në shkallë bashkëkohore, integruese dhe të krahasueshme me standardet e BE-së.

Qëllimi i Institutit ishte të ndihmojë zhvillimin dhe modernizimin e tërësishëm të sistemit arsimor në Kosovë, në përputhje me kërkesat, standardet dhe vlerat e shoqërisë demokratike.

Objektivat e punës së Institutit

Objektivat e punës së IPK-së, ishin:

1. Të ofrojë ndihmë profesionale me qasje të gjerë dhe të shtrirë në përmirësimin e sistemit arsimor - shkollor, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e kohës,
2. Të ndihmojë procesin e zbatimit të risive në arsim përmes aktiviteteve praktike, interpretuese dhe fuqizuese,
3. Të analizojë dhe të krahasojë të arriturat arsimore në Kosovë me vendet tjera,
4. Të hulumtojë dhe të promovojë gjithpërfshirjen, barazinë dhe respektimin e diversitetit në arsim,
5. Te rris ndjeshmërinë e shoqërisë kosovare për rëndësinë e të mësuarit gjatë tërë jetes



6. Të ndërtojë instrumente të qëndrueshme për vlerësim dhe për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe për vlerësimin e shkallës së pritshmërisë,
7. Të fuqizojë format e komunikimit dhe të këmbimit të përvojave informative arsimore në relacionet brenda shkollës dhe jashtë saj,
8. Të ofrojë informim të vazhdueshëm profesional, hulumtues e vlerësues për të gjitha institucionet e interesuara për zhvillimin dhe performancën e arsimit parauniversitar,
9. Të aplikojë metodologji bashkëkohore zbatuese në fushën e hulumtimit, të eksperimentimit, të inovacionit, të vlerësimit dhe të trajnimit, dhe
10. Të përpunojë, të prezantojë dhe të publikojë rezultatet e hulumtimeve të bëra.

Veprimtaria e Institutit

Që nga themelimi, IPK ka ushtruar këtë veprimtari:

1. Ka zhvilluar veprimtari profesionale në funksion të mbështetjes së shkollave, të zyrave administrative arsimore dhe të MASHT-it. Këto veprimtari i realizoi përmes aktiviteteve hulumtuese e trajnuese në aspektin pedagogjik, didaktik e metodik, në bashkëpunim me universitetet dhe agjencitë tjera arsimore,
2. U ka ofruar mbështetje profesionale institucioneve edukative – arsimore, përmes:

- a. Bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes aktive të realizimit të programeve të hulumtimit arsimor lidhur me problematikat që kanë të bëjnë me integrimin dhe gjithpërfshirjen, arsimin e të rriturve, arsimin dhe aftësimin profesional, parandalimin e braktisjes së shkollimit, të informimit dhe të orientimit profesional,
 - b. Ndërtimit të proceseve trajnuese për personelin e shkollës në përputhje me nevojat dhe ofertat trajnuese,
 - c. Punës së drejtpërdrejtë në shkolla, me qëllim të ndërtimit të praktikave më të mira në të gjitha fushat e arsimit,
 - d. Ofrimit të modeleve të reja për ta përmirësuar cilësinë e praktikave shkollore dhe zhvillimin e strategjive mbështetëse në bashkëveprim me agjencitë tjera, dhe
 - e. Ofrimit të modeleve të reja për ta përmirësuar cilësinë e praktikave shkollore dhe për zhvillimin e strategjive mbështetëse, në bashkëveprim me agjencitë tjera.
3. Ka promovuar dhe favorizuar përhapjen e metodologjive dhe praktikave të vlerësimit dhe vetëvlerësimit, duke pasur parasysh përvojat që zhvillohen në Kosovë dhe jashtë saj,
 4. Ka aftësuar kuadrin për punë kërkimore - shkencore gjatë pjesëmarrjes në proceset hulumtuese.

Instituti Pedagogjik e ka filluar punën me këto programe inicuese:

| Fushat | Programet | Projektet prioritare 2008 -2009 |
|----------------------------------|--|--|
| 1. Hulumtimet | <ul style="list-style-type: none"> • Planifikimi shkollor • Studimet krahasuese • Risitë në arsim • Hulumtimet socio-ekonomike | <ul style="list-style-type: none"> • Gjendja arsimore në Kosovë. • Problemet, perspektivat dhe sfidat |
| 2. Planet dhe programet | <ul style="list-style-type: none"> • Planet dhe programet mësimore • Standardet dhe vlerësimet • Aftësimi i mësimdhënësve | <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimet, problemet dhe perspektivat • Trajnimet dhe nevojat trajnuese |
| 3. Arsimi parauniversitar | <ul style="list-style-type: none"> • Arsimi i përgjithshëm • Arsimi profesional • Arsimi për fëmijët me nevoja të veçanta | <ul style="list-style-type: none"> • Braktisja e shkollimit dhe mosvijueshmëria e nxënësve në mësim • Tekstet shkollore në arsimin profesional |
| 4. Arsimi permanent | <ul style="list-style-type: none"> • Arsimi i vazhdueshëm • Arsimi në distancë • Arsimi joformal | <ul style="list-style-type: none"> • Arsimi i të rriturve në raport me mediet dhe teknologjitë e reja të informacionit |

Që nga fillimi i punës, IPK listoi partnerët e mundshëm, siç janë: MASHT, ministritë tjera relevante, Fakulteti i Edukimit, zyrat arsimore, institucionet edukative - arsimore publike dhe jopublike, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), C.E.S.E.S, IRRE Lombardi, UNICEF, UNDP, USAID, OECD, Unioni Evropian, Banka Botërore, GTZ, KosVet, Swisscontact, Save the Children, WHO, FESDK, Kultur - Kontakt, institutet pedagogjike të rajonit dhe me gjerë.

Nga puna e Institutit Pedagogjik përfitues janë nxënësit, mësimdhënësit, drejtuesit e shkollave dhe të institucioneve arsimore, partnerët e IPK-së dhe e tërë shoqëria kosovare.

Struktura organizative e Institutit

IPK, që nga themelimi i tij, ka pas këtë strukturë organizuese: Përbëhet nga dy departmente dhe është i ndarë në sektorë dhe në zyra.

Më poshtë kemi paraqitur listën e stafit të Institutit Pedagogjik, i angazhuar në vitin 2007, që nga themelimi i tij.

Departamenti i Arsimit

| Nr. | Sektorët e IPK | Zyrat e organizuara në sektor | Stafi hulumtues | Udhëheqësit e sektorit |
|-----|--------------------------------|--|--|---|
| 1 | Sektori i hulumtimit | 1. Planifikim shkollor 2. Inovacione dhe studime krahasuese 3. Hulumtime sociale | 1. Safete Shala (2007-...) 2. Mevlude Aliu (2007-...) 3. Zehrie Plakolli (2007-...) 4. Ismet Potera (2007-...) 5. Luljeta Shala (2007-...) 6. Bekim Morina (2007-...) | 1. Ismet Potera (2007-2014) 2. Luljeta Shala (2014-2016) 3. Ismet Potera (2016 - ...) |
| 2 | Sektori i planifikimit mësimor | 1. Planifikimi i programeve 2. Standarde dhe vlerësim 3. Trajnime | 1. Sylejman Berbatovci (2007-2008) 2. Lirije Bytyqi (2010-...) 3. Selim Mehmeti (2007-...) 4. Hajrije Devetaku (2007-2017) 5. Gani Gajraku (2007-2017) 6. Agron Mexhuani (2007-2010) | 1. Hajrije Devetaku – Gojani (2007-2015) 2. Selim Mehmeti (2016- ...) |
| 3 | Sektori i arsimit | 1. Arsimi i përgjithshëm 2. Arsimi profesional 3. Arsimi special | 1. Isa Sylqevci (2007-2008) 2. Skender Mekolli (2007-...) 3. Binak Gërguri (2007-2013) 4. Sylejman Sylejmani (2007-2017) 5. Agim Bujari (2015-...) 6. Muharrem Cermjani (2007-2009) 7. Sahare Reçica (2007-...) 8. Ajshe Balaj (2007) | 1. Muharrem Cermjani (2007-2009) 2. Skender Mekolli (2009 - ...) |
| 4 | Sektori i arsimit permanent | 1. Arsimi permanent 2. Arsimi në distancë 3. Arsimi joformal | 1. Bashkim Azemi (2007-...) 2. Arbnesha Mexhuani (2007-...) 3. Mehrije Halitaj (2007-2014) 4. Haxhere Zylfiu (2007-...) 5. Valmira Peci (2007-2008) | Bashkim Azemi (2007 - ...) |

Të pensionuar

Të punësuar pas themelimit

Kanë ndërprerë marrëdhënien e punës me IPK-në

Të ndarë nga jeta

Departamenti i Administratës

| Nr. | Sektorët e IPK | Zyrat e organizuara në sektor | Stafi hulumtues | Udhëheqësit e sektorit |
|-----|---|---|--|-----------------------------|
| 1 | Spektori i adimistratës | 1. Administrata 2. Buxheti dhe financat 3. Protokoli dhe logjistika | 1. Fitore Maliqi (2010-...) 2. Azem Fetahu (2007-...) | 1. Fitore Maliqi (2010-...) |
| 2 | Spektori i publikimeve dhe i informatikës | 1. Dokumentimi dhe multimedia 2. Publikimet | 1. Fazli Brahaj (2013-...) | |

Të punësuar pas themelimit

Organet drejtuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës

1. Këshilli Drejtues
2. Këshilli Shkencor
3. Kolegji Auditues
4. Drejtori

Instituti Pedagogjik i Kosovës, që nga themelimi i tij, i ka zgjedhur organet drejtuese dhe profesionale, të cilat po i paraqesim ndër vite:

| Periudha | Këshilli Drejtues | Këshilli Shkencor |
|-------------|--|--|
| 2006 – 2010 | <ol style="list-style-type: none"> 1. Munish Hyseni 2. Bisera Bajrami 3. Hyra Salihu 4. Fatmir Elezi 5. Fexhrije Salihu 6. Lumnije Shala 7. Eda Vula | <ol style="list-style-type: none"> 1. Ramadan Zejnullahu 2. Mimoza Shahini 3. Ramë Likaj 4. Vlorë Sylaj 5. Basri Mekolli |
| 2010 – 2014 | <ol style="list-style-type: none"> 1. Selviqe Halimi 2. Ramë Vataj 3. Mevlude Zhushi 4. Jeta Deva 5. Mustafë Kadriu 6. Osman Beka | <ol style="list-style-type: none"> 1. Islam Krasniqi 2. Ganimete Kulingja 3. Merita Shala 4. Labëri Luzha 5. Kemajl Bislimi |
| 2014 – ... | <ol style="list-style-type: none"> 1. Ramush Lekaj 2. Osman Buleshkaj (2014-2017) 3. Bashkim Azemi 4. Fitore Maliqi (2014-2017) 5. Ismet Potera (2014-2016) 6. Labëri Luzha (2016-...) 7. Bekim Morina (2017-...) | <ol style="list-style-type: none"> 1. Hajrullah Koliqi 2. Hatixhe Ismajli 3. Naser Zabeli 4. Linda Grapci 5. Blerim Saqipi |

| Periudha | Drejtorët |
|-------------|-------------------|
| 2007 | Kujtim Rrahmani |
| 2008 – 2010 | Fehmi Ismajli |
| 2010 – 2014 | Nezir Çoçaj |
| 2014 – 2016 | Ismet Potera u.d. |
| 2016 – ... | Labëri Luzha u.d. |

Sfidat e Institutit

Disa nga sfidat me të cilat është ballafaquar IPK:

- Sigurimi i selisë / objektit të IPK-se dhe krijimi i kushteve për punë dhe mirëqenie të stafit të IPK-së,
- Kompletimi i stafit, sipas marrëveshjes për themelimin e IPK-së,
- Mosharmonizimi me kohë i akteve të themelimit të IPK-së me veprimtarinë dhe objektivat e synuara me rastin e themelimit,
- Kufizimet buxhetore për realizimin e projekteve të rëndësisë të veçantë për reformimin e sistemit arsimor,
- Ndryshimet e shpeshta në stafin udhëheqës të institutit,
- Kapacitetet e stafit për përmbushjen e plotë të veprimatrisë dhe të objektiveve të IPK-së.

Infrastruktura ligjore e Institutit

Instituti Pedagogjik i Kosovës veprimtarinë e ka zhvilluar duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ nr. 39/2007, dt. 14.10.2007 dhe me Statutin e datës 05.05.2015 të tij sipas Ligjit për Shërbyesit Civilë. Instituti ka bërë vazhdimisht përpjekje për ta plotësuar dhe harmonizuar Udhëzimin dhe Statutin e vet me Ligjin për Veprimtari Kërkimore - Shkencore. Me plotësimin e këtyre dy dokumenteve Instituti do të kalonte nga Ligji për Shërbyesit Civilë në Ligjin për Veprimtari Kërkimore - Shkencore.

Kështu, IPK në vitin 2016, pas miratimit nga ministri, z. Arsim Bajrami, u themelua grupi punues për plotësimin e Udhëzimit Administrativ dhe Statutit të IPK-së, me çka UA dhe Statuti do të harmonizoheshin me Ligjin për Veprimtari Kërkimore - Shkencore dhe kështu hulumtuesit e IPK-së me ligj do të trajtoheshin si shërbyes profesionalë. Pas pothuaj një vit pune në harmonizimin e këtyre dy dokumenteve ligjore dhe pas diskutimeve të nevojshme me grupe të interesit, ministri i Arsimit në korrik të këtij viti nënshkroi Udhëzimin Administrativ nr. 8/2017 për IPK-në dhe pastaj, më datë 1 gusht 2017, dha edhe pëlqimin për nënshkrim të Statutit të ri të IPK-së. Instituti Pedagogjik, aktualisht, është duke i harmonizuar rregulloret e punës së Institutit, me Statutin e ri të IPK-së.





II. Kush jemi ne

Veprimtaria kërkimore - shkencore

Veprimtaria themelore

Veprimtaria specifike

Parimet e punës

Aktivitetet e tjera

Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion i pavarur publik kërkimor - shkencor me seli në Prishtinë, i cili veprimtarinë e kryen në pajtim me legjislacionin në fuqi. Instituti ka logon dhe vulën e vet të rrumbullakët, me tekstin *“Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë”*. Instituti, poashtu, ka bibliotekën dhe arkivin e vet, që është njësi profesionale organizative e tij.

Veprimtaria kërkimore - shkencore

Veprimtaria e Institutit është veprimtari publike kërkimore - shkencore nga lëmi i edukimit, që realizohet përmes punës krijuese sistematike, që ndërmerret me qëllim të zhvillimit të njohurive të reja, si dhe të shfrytëzimit dhe të zbatimit të tyre në praktikë.

Veprimtaria e Institutit është specifike dhe e orientuar në zhvillimin e edukimit, nëpërmjet:

- hulumtimeve,
- analizave,
- krahasimeve,
- vlerësimeve, dhe
- mbështetjes brenda veprimtarisë së tij.

Veprimtaria themelore

Instituti Pedagogjik i Kosovës veprimtarinë themelore e realizon përmes punës krijuese sistematike, që ndërmerret me qëllim të kërkimit dhe të zhvillimit të njohurive të reja në fushën e edukimit, nëpërmjet:

- Përgatitjes, hartimit dhe realizimit të projekteve të ndryshme kërkimore – shkencore,
- Publikimit të rezultateve kërkimore - shkencore, botimit të revistave dhe botimeve të veçanta, organizimit të konferencave dhe të aktiviteteve të ndryshme shkencore, si: të tryezave, të sesioneve, të simpoziumeve etj.

Veprimtaria specifike

Veprimtaria specifike e Institutit realizohet përmes kërkimeve sistematike në zhvillimin e arsimit, si në pjesëmarrjen në edukim/arsimim, në planifikimin shkollor, në standarde dhe në vlerësim, në tekstet shkollore, në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave, në aftësimin profesional të mësimeve, në shërbimet profesionale dhe veprimtaritë tjera, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e arsimit dhe në zbatimin e tij në praktikë.

Realizimi i veprimtarisë kërkimore themelore dhe specifike mbështetet përmes:

- Krijimit të kushteve për formimin dhe ngritjen e kuadrit shkencor (të brendshëm të Institutit) brenda dhe jashtë Kosovës,
- Sigurimit të infrastrukturës mbështetëse, si: objektit, pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për veprimtarinë kërkimore - shkencore, arkivit, bibliotekës, botimeve shkencore, rrjetit të internetit, literaturës elektronike, laboratorëve kërkimorë - shkencorë etj.

- Bashkëpunimit me institucionet tjera kërkimore shkencore në projektet hulumtuese, si dhe realizimi e veprimtarive të përbashkëta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në planin dhe programin e punës të Institutit gjithashtu përfshihen:

- Projektet kërkimore - shkencore, sipas sektorëve,
- Llojet e kërkimeve shkencore,
- Dinamika, afatet e realizimit dhe objektivat e projektit,
- Plani i aftësisë dhe i ngritjes shkencore dhe profesionale të kuadrit shkencor, hulumtues dhe profesional,
- Format e prezantimit publik dhe të zbatimit të rezultateve kërkimore – shkencore,
- Plani i bashkëpunimit me institucionet kërkimore - shkencore dhe institucionet tjera,
- Çështjet tjera të rëndësishme për aktivitetet specifike kërkimore - shkencore të Institutit.

Parimet e punës

Puna e Institutit bazohet në këto parime:

- Lirisë së kërkimeve shkencore dhe të krijimtarisë,
- Profesionalizmit dhe ligjshmërisë së punës kërkimore – shkencore,
- Mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale,
- Drejtësisë dhe paanësisë, ku çdo anëtar i stafit të Institutit trajtohet në mënyrë të ndershme dhe të paanëshme,
- Etikës dhe përgjegjësisë së punonjësve për rezultatet e punës së tyre

- Konfidencialitetit të punës hulumtuese, sepse çdo anëtar i stafit të Institutit ka përgjegjësi për punën e kryer, për dhënien e informacioneve shkresore apo për dëmet që mund t'i shkaktojë institucionit, individit apo çdo subjekti tjetër,
- Ndërlidhjes së kërkimeve shkencore me sistemin e edukimit,
- Përfshirjes në veprimtarinë shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare,
- Transparencës së punës publike, komunikimit me stafin e Institutit, institucionet arsimore dhe partnerët, me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi.

Aktivitetet e tjera

Instituti, në kuadër të veprimtarisë së vet, organizon tubime dhe aktivitete të ndryshme shkencore, si:

- tryeza,
- sesione,
- simpoziume, dhe
- konferenca shkencore.





III.

Organizimi dhe përbërja e Institutit

Departamenti i kërkimeve në edukim

Departamenti i shërbimeve të përgjithshme

Organogrami

Këshilli Drejtues, Këshilli Shkencor, Drejtori si dhe Sekretari shkencor i Institutit

Stafi aktual i Institutit

Puna kërkimore - shkencore dhe administrative e Institutit Pedagogjik të Kosovës organizohet përmes dy departmenteve, të cilat janë njësi themelore të tij:

1. Departamenti i kërkimeve në edukim, dhe
2. Departamenti i shërbimeve të përgjithshme.

1. Departamenti i kërkimeve në edukim

Departamenti i kërkimeve në edukim përbëhet nga katër sektorë:

- Sektori për hulumtime në edukimin parashkollor,
- Sektori për hulumtime në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët,
- Sektori për hulumtime në arsimin e mesëm të lartë,
- Sektori për hulumtime në arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin gjatë gjithë jetës.

Të gjithë sektorët bashkëpunojnë ndërmjet veti për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore dhe secili prej tyre, përveç punëve tjera që janë me interes për realizimin e detyrave të tyre, kryejnë këto detyra:

- Propozon planin e punës së sektorit dhe e miraton raportin e punës së hulumtuesve,
- Propozon planin e veprimtarisë botuese të sektorit,
- Propozon dhe arsyeton temat për analiza dhe hulumtime të veçanta nga fusha e sektorit,

- Propozon punonjësit apo bashkëpunëtorët profesionalë për aktivitete të veçanta,
- Organizon tubime shkencore, sesione dhe aktivitete tjera shkencore,
- Inicon çështje shkencore me rëndësi për arsimin.

2. Departmenti i shërbimeve të përgjithshme


Departamentin e shërbimeve të përgjithshme e përbëjnë punëtorët e administratës dhe shërbimet tjera mbështetëse të Institutit.

Ky department ndahet në dy sektorë:

- Në sektorin e shërbimeve të përgjithshme, dhe
- Në sektorin e publikimeve.

Departmenti i shërbimeve të përgjithshme kryen punë administrative, juridike, të personelit, financiare - buxhetore, teknike, të teknologjisë informative, të bibliotekës, të arkivit, të logjistikës, si dhe punë tjera.

Organogrami



Në kuadër të strukturës së organeve drejtuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës bëjnë pjesë:

- Këshilli Drejtues,
- Këshilli Shkencor, dhe
- Drejtori.

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues është organ kolegjal qeverisës i Institutit, i cili udhëhiqet nga drejtori dhe

përbëhet nga pesë anëtarë. Në përbërjen e Këshillit Drejtues të Institutit, përveç drejtorit, i cili e udhëheq këtë organ sipas detyrës zyrtare, dy anëtarë që kanë thirrje shkencore i emëron Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe dy anëtarë tjerë janë përfaqësues të departamenteve të Institutit.

Disa nga kompetencat e Këshillit Drejtues, janë:

- Miraton Statutin dhe aktet normative të Institutit,
- Shqyrton dhe miraton raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të Institutit,
- Përgatit raport me shkrim dhe e vlerëson punën e Institutit,
- Ndërmerrë masa për organizimin dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore në Institut,
- Bashkëpunon dhe koordinon punët me drejtorin dhe Këshillin Shkencor për zhvillimin e projekteve profesionale hulumtuese të Institutit,

- Vendos për kërkesat e punëtorëve, që lidhen me çështjet e marrëdhënies së punës.

Këshilli Shkencor

Këshilli Shkencor i Institutit Pedagogjik të Kosovës është organ profesional, i cili përbëhet gjithashtu nga pesë anëtarë; tre prej tyre punonjës shkencorë të Institutit, dy të tjerë i emëron, sipas thirrjes shkencore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ky këshill shqyrton dhe vendos çështjet shkencore dhe profesionale, shqyrton dhe propozon planin e punës kërkimore - shkencore dhe të veprimtarisë botuese të Institutit. Në bazë të propozimeve të sektorëve, Këshilli Shkencor zgjedhë kryeredaktorët dhe anëtarët e redaksive të revistës dhe të botimeve të veçanta të Institutit, si dhe kujdeset për aftësimin kuadrove shkencore dhe profesionale.

Drejtori i Institutit

Drejtori është organ individual i qeverisjes së Institutit, i cili përfaqëson Institutin dhe kujdeset për ligjshmërinë e veprimtarisë dhe të organeve të tij.

Disa nga kompetencat e drejtorit, janë:

- Udhëheq Këshillin Drejtues dhe Këshillin Shkencor të Institutit,
- Udhëheq veprimtarinë e Institutit dhe ndërmerr e masa për realizimin e saj,

Pozita e sekretarit shkencor, aktualisht nuk është e disponueshme, por është e rregulluar me statutin e ri, sipas të cilit sekretari duhet të jetë pjesë përbërse e IPK-së.

- Urdhëron dhe është përgjegjës për zbatimin e planit financiar të Institutit dhe të planit të punës,
- Shpall konkurset për vendet e punës dhe përkujdeset për zhvillimin e procedurave, sipas ligjit,
- Nënshkruan kontratat e punës dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen procedural, sipas ligjit.

Përveç këtyre organeve drejtuese të Institutit, si dhe të stafit që do të paraqesim në vijim, në strukturën organizuese të IPK-së bën pjesë edhe sekretari shkencor i Institutit.

Sekretari shkencor

Sekretari shkencor i Institutit, krahas detyrave të tij të punonjësit shkencor (nga marrëdhënia e punës), kryen edhe disa detyra tjera:

- Bashkërendon veprimtarinë shkencore dhe profesionale me udhëheqësit e departmenteve, të sektorëve dhe të organeve tjera në Institut,
- Ushtron detyrën e drejtorit, kur për shkaqe të arsyeshme këtë detyrë nuk mund ta ushtrojë drejtori i Institutit,
- Organizon dhe bashkërendon veprimtarinë botuese të Institutit,
- Organizon punën kërkimore shkencore të punonjësve të Institutit në terren.

Stafi aktual i Institutit Pedagogjik të Kosovës

| | | |
|----|-------------------|--|
| 1 | Agim Bujari | Zyrtar i lartë për hulumtime në arsim |
| 2 | Arbnesha Mexhuani | Hulumtuese për arsim nga distanca |
| 3 | Azem Fetahu | Logjistikë |
| 4 | Bashkim Ali Azemi | Hulumtues për arsim permanent |
| 5 | Bekim Morina | Hulumtues për çështje socio - ekonomike |
| 6 | Fazli Brahaj | Zyrtar për çështje juridike |
| 6 | Fitore Maliqi | Zyrtare për financa dhe administratë |
| 7 | Haxhere Zylfiu | Hulumtuese për arsim joformal |
| 8 | Ismet Potera | Hulumtues për inovacione dhe studime krahasuese |
| 9 | Lirije Bytyçi | Hulumtuese për plane dhe programe mësimore |
| 10 | Luljeta Shala | Hulumtuese për inovacione dhe studime krahasuese |
| 11 | Mevlude Aliu | Hulumtuese për planifikim shkollor |
| 12 | Safete Shala | Hulumtuese për planifikim shkollor |
| 13 | Sahare Reçica | Hulumtuese për arsim special |
| 14 | Selim Mehmeti | Hulumtues për standarde dhe vlerësim |
| 15 | Skënder Mekolli | Hulumtues për arsim të përgjithshëm |
| 16 | Zehrije Plakolli | Hulumtuese për planifikim shkollor |

Stafi aktual i Institutit Pedagogjik të Kosovës



Stafi aktual i Institutit Pedagogjik të Kosovës






IV. Botimet

Veprimtaria e Institutit përfshinë edhe botimet e rregullta dhe botimet e veçanta të Institutit.

Botim i rregullt i Institutit është revista shkencore “Kërkime Pedagogjike”, si organ i përhershëm i Institutit. Punimet, të cilat botohen në revistën “Kërkime Pedagogjike”, vlerësohen nga redaksia e revistës dhe botohen pas miratimit të Këshillit Shkencor.

Revista “Kërkime Pedagogjike” e Institutit Pedagogjik të Kosovës për herë të parë u botua në vitin 2010 dhe është fryt i një pune gati trevjeçare të hulumtuesve të IPK-së që nga themelimi i këtij institutconi. Tash “Kërkime Pedagogjike” është një periodik vjetor, që trajton punime shkencore në fushën e edukimit, që ka për qëllim të tregojë gjendjen aktuale dhe çështje të ndryshme të këtij digasteri. Pra, trajton problematika të ndryshme, që ndërlidhen me aktualitetin dhe çështjet praktike, duke filluar nga edukimi parashkollor, arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë, arsimi gjatë tërë jetës, si dhe arsimi profesional, që janë me interes për mësimdhënësit, prindërit, studentët, profesorët etj.


Në vijim paraqesim të gjitha punimet, hulumtimet, raportet, studimet, trajtesat, si dhe analizat e botuara në revistën „Kërkime Pedagogjike“, që nga botimi i saj i parë e deri te botimi i fundit i këtij viti.



Kërkime Pedagogjike, 2010

1. Arbnesha Mexhuani: Efekti i teknologjisë informative në procesin e të mësuarit,
2. Bashkim Ali Azemi & Bekim Morina: Aparatura didaktike në tekstet shkollore "Leximi letrar", klasët 6, 7, 8 dhe 9,
3. Bashkim Ali Azemi: Arsimi gjatë gjithë jetës në Kornizën e Kurrikulit të ri të Kosovës,
4. Bashkim Ali Azemi: Arsimi nga largësia dhe arsimi gjatë gjithë jetës,
5. Gani Gajraku & Agron Mexhuani: Autenticiteti dhe vlera e informatave për ndikimin (rezultatet) e trajnimeve të mësimit në mësimdhënës, të mësuesit dhe nxënësit,
6. Hajrije Devetaku & Selim Mehmeti: Vlerësimi i nxënësve – praktikantët dhe treguesit,
7. Hajrije Devetaku, Selim Mehmeti & Haxhere Zylfiu: Braktisja e shkollimit nga nxënësit në Kosovë,
8. Hajrije Devetaku: Tekstet shkollore të gjuhës shqipe në funksion të përmbushjes së rezultateve të pritura,
9. Haxhere Zylfiu & Binak Gërguri: Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale të Kosovës, 2005 – 2008,
10. Haxhere Zylfiu: Komunitetet RAE – Nga mësimi intensiv në mësimin e rregullt 2004 – 2008,
11. Ismet Potera: Teksti mësimor alternativ "Njeriu dhe Natyra",
12. Luljeta Shala: Inovacionet në mësim – Rëndësia e tyre,
13. Luljeta Shala: Mbipopullimi i klasave – Reflektimi në procesin mësimor,


- 14.Mehrije Halitaj: Arsimi në distancë – Mundësi e studimeve pa kufi,
- 15.Mehrije Halitaj: Qendrat për arsim në distancë – Alternativë e re për zhvillimin e arsimit në Kosovë,
- 16.Mevlude Aliu: Kurrikula parashkollore – Zbatimi në praktikë,
- 17.Safete Shala: Mjedisi shkollor dhe ndikimi i tij në procesin mësimor,
- 18.Sahare Reçica: Klasat e bashkangjitura – Mundësi integrimi apo segregimi për fëmijët me nevoja të veçanta,
- 19.Selim Mehmeti: Arsimi gjatë gjithë jetës në kurrikulin e ri të Kosovës dhe në programet shkollore,
- 20.Sylejman Sylejmani: Shkollat e mesme profesionale në Kosovë 2004 – 2008,
- 21.Zehrije Plakolli: Vetëdijësimi i prindërve për rolin e tyre në shkollë dhe në shoqëri.



Kërkime Pedagogjike, 2011

1. Arbnesha Mexhuani: Mësimi në distance,
2. Bashkim Ali Azemi: Arsimi i të rriturve në Kosovë,
3. Bekim Morina: Gjendja socio - ekonomike në arsimin parauniversitar në Kosovë (2000 - 2010),
4. Binak Gërguri & Sylejman Sylejmani: Modelet kurrikulare të AP-së në disa vende evropiane dhe synimet për një model të avancuar kurrikular të arsimit profesional në Kosovë,
5. Gani Gajraku: Kualifikimet, përvojat kualifikuese dhe nevojat për trajnim të mësimdhënësve në Kosovë,
6. Hajrije Devetaku-Gojani: Procesi i zhvillimit të kurrikulit dhe i planeve e programeve mësimore në Kosovë 2001 – 2011,
7. Haxhere Zylfiu: Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në Kosovë,
8. Ismet Potera: Përmbajtja e teksteve shkollore në funksion të arritjes së qëllimeve dhe të objektivave mësimore,
9. Lirije Bytyçi: Harmonizimi i teksteve shkollore të matematikës (klasa e tretë) me planin dhe programin mësimor zyrtar,
10. Luljeta Shala: Mësimi i gjuhës angleze në shkollat e Kosovës, domosdoshmëri për integrim në fushën e dijes,
11. Mehrije Halitaj: Pse i duhet edukimi në distancë Kosovës,
12. Mevlude Aliu – Gashi: Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor në Kosovë,


- 13.Safete Statovci – Shala: Planifikimi dhe organizimi i mësimit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë,
- 14.Sahare Reçica: Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë,
- 15.Selim Mehmeti: Hapat e zhvillimit dhe zbatimit të standardeve arsimore dhe vlerësimit në arsimin parauniversitar në Kosovë,
- 16.Skënder Mekolli: Sistemi i arsimit në Kosovë dhe në disa vende të Evropës,
- 17.Zehrije Plakolli: Rëndësia e funksionimit të komunikimit shkollë-prind.




Kërkime Pedagogjike, 2012

1. Arbnesha Mexhuani: Rëndësia e TIK-ut dhe aktivitetet jashtëshkollore në të nxënit e pavarur,
2. Bashkim Ali Azemi: Të mësuarit e vetorganizuar dhe vetëdrejtuar,
3. Bekim Morina: Gjuha standarde shqipe në shkollat e Kosovës,
4. Binak Gërguri & Sylejman Sylejmani: Modelet kurrikulare për profilet profesionale në Qendrat e Kompetencës nga këndvështrimi i strukturës së planit mësimor,
5. Hajrije Devetaku – Gojani: Zhvillimet në planet dhe programet mësimore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar,
6. Ismet Potera: Rëndësia e të dhënave statistike për vendimmarrje në arsim,
7. Luljeta Bajrami – Shala: Pasqyrim i shkurtër i reformës së sistemit arsimor në Kosovë 2000 - 2010,
8. Lirije Bytyçi – Beqiri: Planifikimi dhe organizimi i piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve mësimore në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë,
9. Osman Buleshkaj & Selim Mehmeti: Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave në Kosovë – Instrumente për vetëvlerësim të performancës dhe vetëzhvillim profesional,
10. Safete Statovci – Shala: Organet e shkollës dhe funksionimi i tyre,
11. Sahare Reçica: Sistemi i mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë,
12. Zehrije Plakolli: Planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës.

1. Bekim Morina: Planifikimi i buxhetit të shkollave,
2. Hajrije Devetaku – Gojani: Ndikimi i vlerësimit të brendshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies,
3. Haxhere Zylfiu: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve të shkollave profesionale të Kosovës dhe identifikimi i nevojave për trajnim,
4. Hysen H. Muzlijaj: Format e bashkëpunimit shkollë – komunitet,
5. Lirije Bytyçi – Beqiri: Gjendja e planifikimit dhe realizimit të mësimin plotësues për nxënësit e shkollës fillore në Kosovë,
6. Luljeta Bajrami – Shala: Rezultatet e provimit të maturës në shkolla profesionale në raport me vlerësimin e brendshëm,
7. Majlinda Zhitia – Gjellaj: Efektet e edukimit parashkollor në përgatitjen e fëmijëve për klasë të pare,
8. Merita Shala, Labëri Luzha: Perspektiva të vlerësimit të problemeve emocionale dhe të sjelljes të fëmijët parashkollorë,
9. Selim Mehmeti: Analizë e trendeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në Kosovë,
10. Vlora Sylaj: Besimi i familjes në shkollë - Faktor me rëndësi në bashkëpunim për parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve.




Kërkime Pedagogjike, 2013




Kërkime Pedagogjike, 2014

1. Arbnesha Mexhuani: Çka e bën një mësimdhënë të suksesshëm,
2. Bashkim Ali Azemi: Ndikimi i interesave në inkurajimin e të rriturve për kualifikim,
